



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
Përmbaruesi Gjyqësor Privat Shefik Suparaku

Ad: Lagj. "Kongresi Elbasanit", Rr. "Koço Brisku", Pallati nr.45/6, kati I, Elbasan, Tel: +355 54516212, e-mail: shefik_suparaku@live.com

Nr.171-01 Regj

Elbasan, me 04.09.2019.

URDHËR
"PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"

Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Biznesit.(Q.K.B-së).

Adresa : Blv "Zhan D'Ark", ish shtëpia e ushtarakëve, Tiranë.

Për dijeni: Shoqërisë "FINSEC PORT" sh.a, NIPT L31909002M, me administrator z.Artan Kraja.

Adresa : Rruga "Ismail Qemali", pall.27, hyrja 1, Kati VI, ap.24, Tiranë.

Për dijeni: Shoqërisë "VICTORIA INVEST" sh.p.k, NIPT K32712206U, me administrator z.Fatmir Kuçi.

Adresa: Lagj. "28 Nëntori", Rr. "11 Nëntori", pallati pranë tatim taksave, Elbasan

Pranë Përmbaruesit Gjyqësor Privat Shefik Suparaku, me kërkesë të palës kreditore është regjistruar për ekzekutim çështja përbarimore me numër 171 regj. dhe me palë:

Kreditor – Shoqëria "VICTORIA INVEST" sh.p.k, NIPT K32712206U, me administrator z.Fatmir Kuçi.

Debitor – Shoqëria "FINSEC PORT" sh.a, NIPT L31909002M, me administrator z.Artan Kraja.

Objekti – Vendosi sekuestro konservative mbi aksionet e palës debitore .

KONSTATOVA:

Pranë zyrës së Përmbaruesit Gjyqësor Privat Shefik Suparaku është rregjistruar kërkesa e palës kreditore për ekzekutimin e titullit ekzekutiv "Vendim gjyqësor për sigurimin e padisë" Nr.10225 akti.datë 31.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Sipas titullit ekzekutiv të sipërcituar është vendosur: "Sekuestro konservative mbi aksionet e Shoqërisë "FINSEC PORT" sh.a, dhe urdhërimi i mostjetërsimit të tyre deri në përfundim të shqyrtimit të padisë."

Përsa sipër Qendra Kombëtare e Biznesit duhet të vendosë masën e sekuestros mbi aksionet e Shoqërisë "FINSEC PORT" sh.a, NIPT L31909002M deri në përfundim të shqyrtimit të padisë, kjo në zbatim të titullit ekzekutiv të sipërcituar.

Për këtë arsye :

Në bazë të neneve 510, 511, 527 e në vijim të K.Pr.Civile,

URDHËROJ :

1. Vendosi e masës së sekuestros konservative mbi aksionet e debitorit Shoqëria "FINSEC PORT" sh.a, NIPT L31909002M, me administrator z.Artan Kraja.
2. Aksionet do të qendrojnë të sekuestruara deri në përfundim të shqyrtimit të padisë.
3. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
4. Per personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren të gjitha masat e parashikuara në neni 598 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vend do të kërkohej ndjekje penale në baze të dispozitave të Kodit Penal.
5. Ky urdhër mbahet e ju njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5(pese) ditëve nga marja dijeni.

PËRMBARUESI GJYQËSOR

Shefik SUPARAKU



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

Nr. 10225 Akti
Datë.Regj 25.06.2019



VENDIM

“PËR SIGURIMIN E PADISË”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

GJYQTARE TEUTA HOXHA

Asistuar nga sekretare gjyqësore Adela Çinari, sot më date 31.07.2019 mori në shqyrtim çështjen civile Nr.10225 Akti me palë:

PADITËS:

Shoqëria “Victoria Invest” shpk (me akronimin V.I.I.G), e regjistruar ne regjistrin tregtar me date 12.03.2003, me NUIS K32712206U, e përfaqësuar me autorizim nga Av.Eno Bezati, me adresë njoftimi Rr: “Panorama”, ND.10, Hyrja 31, Ap.4,1016, Tiranë.

E PADITUR

Shoqëria “Finsec Port” SHA e regjistruar ne regjistrin tregëtar me datë 09.07.2013, me NUIS L31909002M, me adresë Rr: “Ismail Qemali”, Pll.27, Hyrja 1, Kati VI, Ap.24, përfaqësuar me autorizim datë nga Znj. Z. Ilir Kuqi dhe zj.Eltiona Metani jur. e shoqërisë.

OBJEKTI:

Detyrimi i i palës së paditur të shpërblejë dëmin pasuror, në formën fitimit të munguar rrjedhur nga zgjidhja e kontratës së ndërtimit datë 27.04.2015.

Detyrimi i i palës së paditur të shpërblejë dëmin pasuror në formën e humbjes së pësuar dhe shpenzimeve të kryera në funksion të kontratës së ndërtimit datë 27.04.2015

Detyrimi i i palës së paditur të shpërblejë dëmin pasuror, në formën e humbjes së pësuar nga pranimi i faturave fiktive.

Sigurimi i padisë. Vendosja e Sekuestros konservative mbi aksionet e shoqërisë "Finsec Port" Sha me qëllim ndalimin e tjetërsimit të tyre.

Pezullimin e ekzekutimit të kontratave / marrëveshjeve të nënshkruara nga ndërmjet të paditurit dhe palëve të treta pas datës 06.11.2018 me vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë për të cilat nuk është marrë miratimi nga Këshilli Mbikqyrës dhe Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve.

Ndalimi i nënshkrimit të kontratave / marrëveshjeve të reja me vlerë më të lartë se 5% të aksioneve të shoqërisë pa u marrë paraprakisht miratimi nga Këshilli Mbikqyrës dhe Asambleja e Përgjithshme .

Baza ligjore:

Nenet 202 e vijues te K.Pr.Civile.

GJYKATA

Si çeli séancen gjyqësore në prani të përfaqësuesve të palëve; përkatësisht pala paditëse kërkoi pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë, ndërsa pala e paditur kërkoi rrezimin e saj; dhe si shqyrtoi aktet e paraqitura deri në këtë fazë të gjykimit;

VËREN

Pala Paditëse, shoqëria "Victoria Invest" SHPK është një shoqëri e së drejtës shqiptare që ushtron aktivitetin e saj kryesisht në fushën ndërtimit të veprave civile dhe industriale, ndërtimin e rrugëve, autostradave, ujësjellësve, gaz-sjellësve, porteve, ndërtimeve të tjera detare etj.

Pala e paditur shoqëria "Finsec Port" SHA është një shoqëri gjithashtu e së drejtës shqiptare e regjistruar në Regjistrin Tregtar më datë 09.07.2013, me Nr. NUIS L31909002M. Objekti i aktivitetit të të paditurit është: - *"Zbatimi dhe përmbushja e kushteve të kontratës së koncesionit miratuar me VKM nr. 505 datë 30.05.2013 si dhe çdo aktivitet tjetër ndihmës apo plotësues në funksion të zbatimit dhe përmbushjes së kushteve të kontratës së koncesionit"*.

Aksionarë aktualë të shoqërisë "Finsec Port" SHA janë: Finsec AG, Shoqëri e së drejtës tregtare Zvicerane zotëruese e 80% të aksioneve dhe shoqëria "Victoria Invest" SHPK zotëruese e 20% të aksioneve.

Më datë 22.08.2014, Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), me Vendimin Nr. 4, ka miratuar Lejen Zhvillimore Komplekse për ndërtimin e "Portit të Jahteve" në Kalanë e Turrës, Komuna Synej, Kavajë, që përbën edhe objektin e koncesionit miratuar me VKM nr. 505 datë 30.05.2013.

Pas miratimit të Lejes Zhvillimore, më datë 27.04.2015, ndërmjet shoqërisë "Finsec Port" SHA në cilësinë e Investitorit dhe shoqërisë "Victoria Invest" SHPK në cilësinë e Nënkontraktorit, është nënshkruar Kontrata e Ndërtimit nëpërmjet së cilës pala paditëse merre përsipër kryerjen e punimeve të përcaktuara në objektin e kontratës, që do të kryeheshin sipas fazave të dakordësuara. Kontrata e sipërcituar e Ndërtimit është ndryshuar nga palët me dy amendamente të njëpasnjëshme, i pari i datës 17.10.2015 dhe i dyti i datës 08.12.2015.

Pala paditëse në përmbajtje të kërkesë-padisë dhe në shpjegimet e dhëna në seancat e zhvilluara ka parashtruar se :

-Me nënshkrimin e kontratës së ndërtimit dhe amendamenteve respektive, shoqëria "Victoria Invest" SHPK, ka realizuar të gjitha punimet e ndërtimit në përputhje me projektet e ndërtimit, zbatimit dhe përshkrimeve të detajuara teknike të përcaktuara në kontratë dhe amendamentet e saj. Punimet e ndërtimit të realizuara nga paditësi, janë çertifikuar dhe pranuar nga Supervizori i punimeve i caktuar nga investitori fakt që provohet nga situacionet përkatëse të nënshkruara nga firma Tirana Supervision, e nënkontraktuar nga investitori.

"Finsec Port" SHA, në kundërshtim të plotë me parashikimet kontraktore, nuk ka kryer pagesat për punën e kryer në përputhje me kohën dhe masën e duhur dhe lidhur me këtë problematikë shoqëria "Victoria Invest" SHPK ka njoftuar disa herë Mbikëqyrësin e punimeve dhe Administratorin e "Finsec Port" SHA.

Paditësi ka parashtruar gjithashtu se pala e paditur nuk ka qënë korrekte edhe në raport me detyrimet kontraktore kundrejt shoqërisë Mbikëqyrëse e punimeve gjë që ka çuar në zgjidhjen e kontratës së nënshkruar edhe me Mbikëqyrësin. Në kuadër të kërkesave për pagesë dhe njohje të punimeve të kryera ka patur një "Marrëveshje së mirëkuptimi" më datës 22 Korrik 2017, ndërmjet përfaqësuesit të Aksionarit të maxhorancës të "Finsec Port" SHA, z. Andreas Mattig) dhe "Victoria Invest" SHPK, nëpërmjet së cilës është dakordësuar se:- *"detyrimet e papaguara dhe dëmi i shkaktuar do të likujdoheshin brenda një periudhe të shkurtër, por jo më vonë se data 31 Dhjetor 2017"*.

Paditësi ka parashtruar se pavarësisht kësaj gjendjeje, ka marrë masat për ruajtjen e punimeve të kryera dhe mos dëmtimin e tyre nga kushtet e motit apo agjentë të tjerë natyrorë kjo edhe për faktin se paditësi është njëkohësisht edhe aksionar i shoqërisë koncensionare. Të tilla kanë qenë punimet të riparimit dhe rikuperimit të materialit në port gjatë Dhjetorit 2017. Për shkak të reshjeve të dendura të shiut dhe prurjeve të mëdha të ujit, "Victoria Invest" SHPK u detyrua me makineritë dhe pajisjet e saj, të kryente punime të tjera, synimi i të cilave konsistonte në ruajtjen fizike të veprës së realizuar deri në këtë moment.

Paditësi ka parashtruar se më datë 06.02.2018, "Victoria Invest" SHPK (në cilësinë edhe të aksionarit), ka njoftuar në mënyrë të përsëritur Investitorin për problematikat të cilat mund të çonin deri në mos përmbushje të kontratës së koncesionit për faj të "Finsec Port" SHA duke

evidentuar si të tilla: (i), vonesat në pagesën e kontraktorit dhe keq menaxhimi financiar, (ii) mungesa e Mbikëqyrësit në objekt (për shkak të mospagesës edhe mbikëqyrësi braktisi kantierin), (iii) pasojat negative në mjedis ose katastrofa mjedisore për shkak të braktisjes së projektit, (iv) shpërdorim detyre nga menaxhimi si pasojë e mos veprimeve dhe braktisjes, (v) kompensim dëmi në përputhje me Kodin Civil RSH, (vi) njoftim i institucioneve mbi situatën përkatëse.

-Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit me procesverbalin nr. 24 datë 30.04.2018, ka aplikuar gjobë ndaj "Viktoria Invest" duke lënë si detyre : "hapje e kanalit dhe kthimi në normalitet", pasi për shkak të mungesës së udhëzimeve të nevojshme ndaj sipërmarrësi dhe defekteve të projektit ,për shkak të shirave , rrezikohen furnizimi me ujë i disa fshatrave ,në kushtet kur rezultoi i gabuar udhëzimi nga Projektuesi, (sipas palës paditëse Arti Proje Ltd në cilësinë e projektuesit ishte i pa licensuar sipas legjislacionit shqiptar) për mbylljen e kanalit, dhe në këto kushte paditësi referon se ka marrë masa masa për zgjidhjen e përkohshme të situatës.

Paditësi ka parashtruar se në këto rrethana, në mungesë të udhëzimeve nga investitori dhe Mbikëqyrësi i punimeve si dhenë mungesë së lejes së posaçme për të mbajtur mbyllur grykëderdhjen e përroit si dhe në zbatim të nenit 66 ligjit Nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" (i ndryshuar 2018), zbatoi ligjin përkatës në lidhje me lejet dhe autorizimet për menaxhimin e burimeve ujore për pjesën e hapjes së kanalit duke kryer punimet e domosdoshme për hapjen e kanalit, fakt që u pohua nga pala e paditur në seancat gjyqësore të zhvilluara për shqyrtimin e kërkesës për sigurimin e padisë.

Në këto kushte paditësi pretendon se në përputhje me nenin 862 të Kodit Civil, legjitimohet për një kompensim të drejtë (duke marrë në konsideratë që në projektin përfundimtar, kanali do të hapej përsëri).

Paditësi ka parashtruar se pas konstatimeve të IKMT si më lart është konsultuar me kompani të specializuara dhe në bazë të udhëzimeve të tyre ka marrë masat e nevojshme për vazhdimin e projektit duke krijuar një zonë të mbrojtur provizore për mjetet që nevojiteshin për vijimësinë e projektit si mjetet lundruese, transporti polombarëve dhe vinçat , punime këto të domosdoshme dhe në përputhje me kontratën kornizë dhe qëllimin e koncesionit. Mbështetur në parashikimet e kontratës ,Aneksi Nr. 2, date 08.12.2015 pala paditëse pretendon se ka kryer mirëmbajtjen e rrugës segmenti nga dalja e autostradës deri te hyrja ne Portit punime këto që sipas paditësit janë imponuar edhe nga shkresa nr.278 prot datë 28.05.2018 nëpërmjet së cilës Bashkia Kavajë i ka kërkuar palës paditëse ndërhyrjen ne aksin rrugor Synej- Bago dhe Bago - Peqinaj për shkak të dëmtimit të saj nga qarkullim i mjeteve të rënda, duke kërkuar riparimin e rrugës.

Paditësi ka pretenduar se vlera e kërkuar nga pala e paditur arrin në shumën mbi 5,632,327 Euro pa përfshirë interesat, përbëhet nga vlera punimeve të domosdoshme të tilla si hapja e kanalit dhe zhblokim i ujërave, çlirimi i rrugës, rehabilitimi i rrugës së hyrjes pe më port, punimet e tjera të

imponuara nga udhëzimet e gabuara të projektuesit. Gjithashtu pala paditëse ka parashtruar se vlera e pretenduar si dëm i shkaktuar ka ardhur si pasojë e mbikqyrjes së punimeve në kantier dhe mbajtjes stabël të gjendjes në kushtet e mungesës së financimeve nga pala paditur, gjatë kohës së vazhdimit të kontratës.

Pala paditëse ka pretenduar se puna në kantier ka filluar nga janar 2017, ndërsa pala e paditur nuk është treguar korrekte me pagesat, duke kërkuar me shkresë edhe uljen e ritmeve të punimeve për një vlerë të caktuar të reduktuar mujore sipas e-mailit të datës 12.03.2017, për mungesë të fondeve për financimin e projektit. Paditësi ka pretenduar se punimet kanë rifilluar në maj 2017 dhe deri në këtë moment kantieri kishte qëndruar i hapur për një periudhë prej afro 5 muaj. Në maj 2017 puna ka rifilluar me ritme të larta dhe nëse do të ishte ruajtur ai ritëm, punimet në portin e jahteve do të kishin përfundur brenda vitit 2019. Në shtator 2019 është larguar mbikqyrësi i punimeve për shkak të mospagesës së tij nga pala e paditur. Për periudhën janar- mars 2017 dhe shtator -dhjetor 2017, paditësi pretendon se ka mbajtur hapur kantierin me shpenzimet e tij. Sipas palës paditëse kostoja e mbajtjes hapur të kantierit dhe e ruajtjes së gjendjes së punimeve arrinte deri në 210.000 Euro në muaj vlerë kjo e njohur dhe pranuar sipas kësaj pale, në marrëveshjen e 22 korrikut 2017 mes përfaqësuesit të paditësit dhe aksionarit mazhortiar të koncesionarit.

Pala paditëse ka parashtruar se pala e paditur ka ngritur pretendime për punime të realizuara tej kushteve teknike, megjithëse këto konstatime pranohet se nuk janë bërë nga persona kompetentë. Në këto kushte pala paditëse ka parashtruar se ka marrë konsulencë nga shoqëria e specializuar ITM shpk dhe mbi këtë bazë kanë rifilluar punimet.

Në vijim të problematikave të konstatuara lidhur me projektin, udhëzimet e gabuara, pala paditëse parashtrroi se ka njoftuar Investitorin, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për gjendjen në objekt, mundësinë e realizimit të projektit.

Pala paditëse ka paraqitur një sërë komunikimesh me e-mail mes përfaqësuesve të saj palës së paditur nga ku evidentohen problematikat e hasura me zbatimin në vend të projektit, dhe diferencat në sasinë e materialit të parashikuar me ato të nevojshme në projekt si dhe problematika të tjera shkaktuar nga faktorë të jashtëm të tilla si reshjet, temperaturat e ulta erozionet, e të ngjashme. Po ashtu në këto komunikime, paditësi ka parashtruar edhe rrugën që ai propozon për zgjidhjen e vazhdimit të projektit dhe çështjes së kredisë (të drejtave) të palës paditëse ndaj palës së paditur.

Pala paditëse ka parashtruar se i ka drejtuar një numër të madh kërkesash administratorit të Anëtareve të Bordit Drejtues të palës së paditur lidhur me problematikat e hasura.

Me kërkesën e datës 07.05.2018 pala paditëse i ka drejtuar palës së paditur një ftesë për mbledhjen e Asamblesë së Shoqërisë "Finsec Port" SHA duke shtruar një sërë çështjes për shqyrtim për t'u përfshirë në rendin e ditës të tilla si: informimi i aksionarëve në lidhje me projektin (pas parashtrimit se projekti është jashtë kushteve , tej afatit, dhe aksionari mazhoritar nuk ka përmbushur detyrimet për financimin e tij) ; informimi në lidhje me financimin e projektit burimin e financimit, garancite dhe afatet e disbursimit; Informimi për dëmet dhe pasojat e mosfinancimit; vendimmarrje lidhur me ekspertin kontabel; demet e shkaktuara nga veprimet dhe mosveprimet;

Rezulton se më datë 06.11.2018 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, pas kryerjes së inspektimeve në vend ka vendosur "Zgjidhjen e kontratës koncesionare".

Paditësi ka pretenduar se edhe pas këtij momenti pala e paditur ka proceduar me lidhje kontratash dhe lëshim faturash për llogari të kompanive të familjarëve të aksionarëve të Bordit drejtues pa u marrë apo kryer asnjë produkt për llogari të shoqërisë, dhe në këtë mënyrë pala paditëse pretendon se cënohen të drejtat e tij si nënkontraktor por edhe si aksionar i shoqërisë.

Për të gjitha sa më lart, pala paditëse ka kërkuar nëpërmjet kërkesë padisë pagimin e vlerës së punimeve të kryera, pagimin e vlerës për mirëmbajtjen e kantierit, pagimin e kamatave respektive si dhe sigurimin e padisë sipas kërtimeve në objektin e padisë.

Në mbështetje të pretendimeve pala paditëse ka paraqitur edhe një akt ekspertimi realizuar nga Ing. Hetem Xhamëmi nëpërmjet të cilit paditësi ka parashtruar vlerësimin e kostos dhe dëmit ekonomik për mjetet dhe pajisjet sipas kontratës së lidhur me palën e paditur.

Përfaqësuesja e palës së paditur ka parashtruar në seancë se nuk janë kushtet ligjore për sigurimin e padisë duke rezervuar të drejtën që shpjegime më të plota për çështjen ti parashtrojë në Deklaratën e Mbrojtjes.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e ka zgjidhur kontratën koncesionare me shkresën nr.11206/4 prot datë 06.11.2018 "Njoftim për Zgjidhjen e Kontratës Koncesionare për ndërtimin e Portit të Jahteve në Kalanë e Turrës, Komuna Synej Kavajë". Mbi pyetjet e e shtruar nga gjykata, përfaqësuesja e palës së paditur deklaroi se nuk janë kërkuar kryerje e punimeve të domosdoshme nga pala paditëse, ndonëse punimet të tilla janë kryer nga paditësi siç është hapja e kanalit.

Me shkresën nr.3742 datë 02.04.2019 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka vendosur: "Anullimin e vendimit të datës 06.11.2018 dhe vazhdimin e Kontratës Koncesionare".

Ligji i zbatueshëm

Neni 202 i Kodit të Procedurës Civile përcakton *rastet ligjore* se kur mund të vendosen masat e sigurimit të padisë duke parashikuar se:

“Me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë.

Sigurimi i padisë lejohet kur:

- a) padia mbështetet në prova me shkresë;*
- b) paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund të shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.*

Garancia mund të kërkohet edhe për rastin e parashikuar nga shkronja “a” e këtij neni.”

Në vijim, në nenin 203 të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet ndër të tjera se sigurimi i padisë lejohet për të gjitha llojet e padive dhe në çdo fazë të gjykimit, derisa vendimi të marrë formë të prerë.

Neni 204 të K.Pr.Civile parashikon shprehimisht se: *“Sigurimi i padisë mund të kërkohet edhe para ngritjes së padisë në gjykatën e vendit ku ka banimin paditësi ose ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia.*

Në këtë rast, gjykata cakton një afat jo më shumë se pesëmbëdhjetë ditë, brenda të cilit duhet të paraqitet padia në gjykatë”.

Sa i përket llojit të masave që mund të vendosë gjykata për sigurimin e padisë ato parashikohen por *jo në mënyrë shteruese* në nenin 206 të Kodit të Procedurës Civile në të cilin përcaktohet qartë se:

“Sigurimi i padisë bëhet:

a) me sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të kredive të debitorit;

b) me marrjen nga ana e gjykatës të masave të tjera të përshtatshme, duke përfshirë edhe pezullimin e ekzekutimit.

Gjykata mund të lejojë sigurimin e padisë me disa nga llojet e ndryshme të masave të sigurimit, por gjithmonë për një shumë të përgjithshme jo më të madhe se atë të padisë.

Sekuestër nuk mund të vihet mbi sende që, sipas nenit 529 të këtij Kodi, nuk mund të sekuestrohen.”

Gjykata; Në analizë të pretendimeve të paraqitura dhe rrethanave të çështjes çmon se:

III. Kërkesa për sigurimin e padisë synon garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektin e garancisë së një gjykimi efektiv, nëpërmjet të cilit të drejtat e fituara nëpërmjet vendimit përfundimtar në gjykimin e themelit, të mund të rivendosen në gjendjen e mëparëshme në mënyrë të plotë duke u siguruar në këtë mënyrë zbatimin e vendimit të dhënë. Vendi i dhënë

synon që të mbajë një situatë konstante, që mundëson eventualisht ekzekutimin e vendimit përfundimtar dhe nuk paragjykon zgjidhjen në themel të çështjes. Në këto kushte nëpërmjet masës së sigurimit të padisë gjykata garanton në mënyrë paraprake por indirekte, zbatimin e vendimit të saj përfundimtar në eventualitet të shpalljes gjyqfitues të personit me kërkesë të të cilit aplikohet kjo masë.

Nga shqyrtimi në seancë pregatitore i provave të paraqitura bashkëlidhur padisë gjykata çmon se ekzekutimi i vendimit përfundimtar për të drejtat e palës paditëse mund të jetë i pamundur ose i vështirë. Në rrethanat e mësipërme, gjykata vlerëson që me qëllim që të sigurohet zbatimi i vendimit përfundimtar në eventualitet të pranimit të padisë, të pranojë pjesërisht kërkesën e paraqitur për sigurimin e padisë duke disponuar me ndalimin e tjetërsimit të aksioneve të shoqërisë "Finsec Port" Sha deri në përfundim dhe marrjen formë të prerë të gjykimit të kësaj çështjeje.

Lidhur me masat e tjera të sigurimit të padisë gjykata çmon se ato lloj masash nuk përkojnë me të drejtat e pretenduara në gjykim, dalin jashtë objektit dhe natyrës së këtij gjykimi dhe për rrjedhojë nuk konsiderohen si mjete efektive për garantimin e ekzekutimit të të drejtave të pretenduara nga pala paditëse nëpërmjet kësaj padie, me objekt dhe shkak ligjor të përcaktuar si më lart referuar.

PËR KËTO ARËSYE

Gjykata, bazuar në nenet 202 e vijues të K. Pr. Civile;

VENDOSI

- Pranimin e pjesshëm të kërkesës për sigurimin e padisë.
- Vendosjen e sekuestros konservative mbi aksionet e shoqërisë "Finsec Port" Sha dhe urdhërimin e mostjetërsimit të tyre deri në përfundim të shqyrtimit të padisë.
- Rrëzimin e kërkesës për marrjen e masave të tjera të sigurimit të parashtruara në padi.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 5 ditëve afat që fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arësytuar.
- U shpall në Tiranë më 31.07.2019

SEKRETARE

Adela Çinari



GJYQTARE

Teuta HOXHA

